

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTRE

Miratuar nga:

ADMINISTRATOR

ERGYS VERDHO

KËRKESË PËR PROPOZIM

Kontakt

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

“Rr. Viktor Eftimiu, Nr. 12, Tiranë, Shqipëri; Tirana, Albania

Në vëmendje të:

Divizioni i Administrimit

da@kesh.al

KËRKESË PËR PROPOZIM

1. QËLLIMI

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.), ka kënaqësinë t'ju ftojë të paraqisni një propozim me shkrim për të vepruar si Këshilltar Financiar për “Shërbimin e Këshillimit Financiar (FA) për financimin e projektit për ndërtimin e HEC Skavica”.

2. KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, aktualisht është duke zhvilluar projektin e Hidrocentralit të Skavicës (“HEC-i i Skavicës” ose “Projekti”). KESH sh.a synon që në kuadër të zbatimit/zhvillimit të projektit, të marrë shërbimet e këshillimit financiar nga një shoqëri këshilluese financiare-juridike me kualifikim dhe përvojë të përshtatshme për të vepruar si Këshilltar Financiar-Ekonomik (“Këshilltari Financiar” ose “FA”) të Projektit.

3. FONDI LIMIT

450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) EURO, (VAT Excluded).

4. KOHËZGJATJA DHE AFATI I SHËRBIMIT

6 (gjashtë) muaj.

5. PËRMBAJTJA E PROPOZIMIT

Propozimi Teknik përfshin

- i. Një përshkrim i detajuar i shërbimeve të propozuara dhe metodologjisë, e cila përmban të gjithë informacionin e kërkuar nga dokumenti i Termave të Referencës, në mënyrë që të përcaktohet nëse shërbimet e propozuara plotësojnë kërkesat e specifikuara këtu:
- ii. Ofertuesi duhet të paraqasë personelin, i cili duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në projekte të mëdha, në fushën/ekspertizën e mëposhtme:
 - Drejtues Ekipi - Ekonomist me minimumi 12 (dymbëdhjetë) vite përvojë:
 - Audit dhe Financë;
 - Ekspert financiar i ECA-s;
 - Ekspertizë e Parashikimit të Energjisë
 - Parashikimi i Çmimeve të Energjisë
 - Inxhinieri dhe vlerësues për CAPEX
 - Ekspert financiar i profilit energjetik për analizat OPEX
 - Ekspertiza e parashikimit financiar
 - Ekonomist për ndikimet makro
 - Financimi i ECA-s.

** Për personelin e sipërpërmendur, duhet të dorëzohen Curriculum Vitae dhe referenca për shërbimet e kryera në kontrata të ngjashme.*

- iii. Konfliktet e interesit: Ofertuesi duhet të deklaroj çdo konflikt interesi që kompania mund të hasë gjatë rrjedhës së detyrës;
- iv. Të sigurojë ofertën në masën 2% të fondit limit të kontratës;
- v. Ofertuesi duhet të paraqes pasqyrat financiare të audituara të 2 viteve të fundit, ku të paktën në njërin prej tyre duhet të ketë të ardhurat (xhiro) në vlerën minimale prej 1.5 (një pikë pesë) Milion Euro ose ekuivalente.

Propozimi Financiar

- i. Propozimi teknik duhet të dorëzohet së bashku me një propozim financiar (“propozimi financiar”). Të gjitha çmimet e propozuara do të jenë fikse dhe nuk i nënshtrohen rishikimit.
- ii. Kandidati duhet të paraqesë:
Oferta ekonomike duhet të dorëzohet sipas segmentimit/planit referuar Termave të Referencës (neni 7 i ToR).

6. KRITERET E VLERËSIMIT

Sipas rëndësisë, propozimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit	Pikët
1. Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	[50]
2. Qasja dhe Metodologjia Teknike	[35]
3. Oferta Ekonomike	[15]

Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar: Ofertuesi duhet të përshkruajë personelin që do të angazhohet në kontratë me përvojë të mjaftueshme për të kryer me sukses shërbimin e kërkuar. Për të treguar këtë fakt, operatori duhet të paraqesë për secilin personel kryesor dokumentacionin e kërkuar në kërkesën 5.ii. dhe ToR. Për personelin duhet të dorëzohet Curriculum Vitae dhe referenca për shërbimet e kryera në kontrata të ngjashme.

Qasja dhe Metodologjia Teknike: Ofertuesi duhet të japë një përshkrim të detajuar të kompanisë, duke përshkruar projektet e kryera, certifikimet - standardet që ka, etj. Ofertuesi duhet të shpjegojë se ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, qasjen

teknike, metodologjinë për të kryer aktivitete të ndryshme duke përfutur nga rezultatet e pritshme dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve.

Ofertuesi duhet të prezantojë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë qasjen teknike që do të adoptohet për zgjidhjen e tyre.

Ofertuesi duhet të shpjegojë metodologjinë që ai propozon të miratojë dhe të paraqesë përputhshmërinë e këtyre metodologjive me qasjen e propozuar (në këtë rast ofertuesi nuk do të përsërisë/kopjojë RfP-në).

Oferta Ekonomike: Të gjitha çmimet e propozuara do të jenë fikse dhe nuk i nënshtrohen rishikimit.

Kandidati duhet të dorëzojë:

- a. Oferta ekonomike duhet të dorëzohet sipas planit në termat e referencës.
- b. Propozimi Çmimit Total pa TVSH dhe shuma e TVSH-së.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Cmimi më i ulët i ofertuar

Ç - Çmimi i ofertës tjetër të rradhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$

(Çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

- **Vlerësimi Final**

Pesha për Propozimet Teknike dhe Financiare jepet si më poshtë:

- **Pesha për Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar: X = (pikët e propozimit teknik përkatës x 0.5).**
- **Pesha për Qasjen Teknike dhe Propozimin e Metodologjisë: Y = (pikët e propozimit teknik përkatës x 0.35).**
- **Pesha për Propozimin Ekonomik: Z = (pikët për propozimin ekonomik x 0.15)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe pikëve të propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta Fituese} = X+Y+Z$$

Ofertuesi i cili ka marrë më shumë pikë gjatë grumbullimit të pikëve tekniko-ekonomike do të ftohet për të negociuar dhe lidhur kontratën.

7. Procesi i Dorëzimit

Zarfi i mbyllur duhet të dorëzohet në protokollin e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare i mbyllur dhe jo transparent:

Nënshkruar dhe me këtë shënim:

- Adresa;
- Me shënimin: “Propozim për Shërbimin e Këshillimit Financiar”
- Data dhe ora e hapjes së zarfit;
- Emri i Ofertuesit.

Të dyja gjuhët anglisht ose shqip do të pranohen për Ofertën dërguar Korporatës Energjetike Shqiptare.

Zarfi duhet t'i dërgohet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare me datën 15/02/2024; në orën 11:00 AM (zona kohore UTC+1).

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare rezervon të drejtën të refuzojë çdo propozim që nuk është marrë deri më tani.

Propozimet do të hapen nga komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 15/02/2024; në orën 11:00 AM (zona kohore UTC+1).

8. KONFLIKTET E INTERESIT

Këshilltari Financiar duhet të angazhohet, gjatë gjithë misionit, të ofrojë këshilla profesionale, objektive dhe të paanshme dhe të ruajë, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, interesat e Republikës së Shqipërisë. Këshilltari Financiar duhet të shmangë situatat e konfliktit të interesit me misione ose interesa të tjera.

9. KONFIDENCIALITETI

Dokumentet dhe të dhënat që do t'i dërgohen nga ju Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare do të konsiderohen konfidenciale dhe nuk do t'u transmetohen palëve të treta.

10. INFORMACION TJETËR

Pas përzgjedhjes së finalistit, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare do të negociojë një marrëveshje që do të jetë në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja do të mbulojë të gjitha aspektet e propozimit të përshkruara këtu.

Kompani: **KOORPORATA ELEKTRO ENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A**

Dokument: **Termet e Referencës**

Shërbimi: **Shërbime Këshilltari Financiar i KESH sh.a.**

Projekt: **Hidrocentrali Skavica**

Vendodhje: **Kukës – Dibër, Shqipëri**

Statusi i Dokumenti: **Final**

Përgatitur nga: **KESH sh.a.**

PËRMBAJTJA

1. SFONDI	9
1.1. Qëllimi	9
1.2. Shkurtime dhe Akronime	9
1.3. Përkufizime	9
1.4. Legjislacioni i Aplikuar	10
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	10
2.1. Vështrim i Përgjithshëm mbi Klientin	10
2.2. Përshkrimi i Projektit Skavica	11
2.3. Palët kryesore të lidhura	11
3. OBJEKTIVAT E SHËRBIMIT	11
4. FUSHA E VEPRIMTARISË	12
4.1. Informacion i Përgjithshëm	12
4.2. Përshkrimi dhe Fazat e Fushës së Veprimtarisë/Shërbimeve	13
4.2.1 Detyra 1 – Bankabiliteti i KESH	13
4.2.2 Detyra 2 - Fizibiliteti Financiar i HEC-it të Skavicës	13
4.2.3 Detyra 3 - Fizibiliteti Ekonomik i HEC-it të Skavicës	16
4.2.4 Detyra 4 – Rishikon dhe Ndryshon SoW të Organizuesit Financiar Potencial	16
4.3. Takimet dhe Marrëdhëniet	16
4.4. Support	16
4.5. Raporte dhe Dorëzime	16
5. KRITERET E PRANUESHMËRISË	17
6. KUALIFIKIMET DHE KËRKESAT	18
7. KOHËZGJATJA DHE PESHA FINANCIARE SIPAS DETYRAVE	19

1. SFONDI

1.1.Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti të “Termave të Referencës” (në vijim të referuar si ToR) është të përshkruajë Shërbimet që do të ndërmerren nga Këshilltari Financiar për Projektin e HEC-it Skavica.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (“KESH sh.a.” ose “Klienti”), aktualisht po zhvillon projektin e Hidrocentralit të Skavicës (“HEC-i i Skavicës” ose “Projekti”). KESH sh.a synon, në kuadër të zbatimit/zhvillimit të projektit, të marrë shërbimet e këshillimit financiar nga shoqëri këshilluese financiare-juridike të kualifikuara dhe me përvojë të përshtatshme për të vepruar si Këshilltar Financiar-Ekonomik (“Këshilltari Financiar” ose FA) i Projektit.

Titulli i Projektit: **Hidrocentrali Skavica**
Shërbimi i Kërkuar: **Shërbim Këshillimi Financiar**

1.2.Shkurtime dhe Akronime

ToR	Termet e Referencës
SoW	Fusha e Veprimtarisë
HEC	Hidro-Elektro Central
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
FA	Këshilltar Financiar
ECA/DFI	Agjenci e Kredisë së Eksportit/ Institucion Financiar i Zhvillimit
GoA	Qeveria e Republikës së Shqipërisë
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare (pjesë e Bankës Botërore)

1.3.Përkufizime

Klient:	I referohet KESH sh.a.
Këshilltar Financiar:	I referohet subjektit (kompanisë) që do t'i ofronte Klientit, shërbimet e kërkuara të përshkruara në ToR.
Objekti:	I referohet objektit të këtij ToR, që është kryerja e të gjitha shërbimeve të kërkuara për Projektin e HEC-it të Skavicës.
Dorëzime:	I referohet raporteve/dokumentave që Këshilltari Financiar duhet të paraqesë si rrjedhojë e shërbimeve të kryera.

Ofertuesi:	I referohet pjesëmarrësve në procesin e tenderimit, të ftuar për të dorëzuar Ofertat e Tenderit për të ofruar shërbimin e kërkuar sipas kushteve të përcaktuara në ToR. Nëse kontrata fitohet, ofertuesi do të referohet si Këshilltar Financiar.
Formati Original:	I referohet dorëzimit të dokumentave në formë elektronike të redaktueshme të paraqitura nga Këshilltari, në programin që ky dokument është hartuar fillimisht (si p.sh.; PDF, MS Word, MS Excel, MS Power-Point etj.).
Forma e Printuar:	2 (dy) kopje të printuara që KF duhet të dorëzojë në përfundim të punës sipas çdo detyre të fushës së veprimtarisë. Kopjet e printuara duhet të jenë të firmosura dhe me vulën zyrtare të Këshilltarit Financiar.

1.4. Legjislacioni i Aplikuar

KF duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e kuadrit ligjor shqiptar që është i zbatueshëm në sektorin e shërbimeve të kërkuara.

Kuadri ligjor bazohet në dispozitat:

- Ligji nr. 38/2021, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International INC.”, për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës;
- Vendim nr. 485, datë 30.07.2021, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës I "Kontrata për shërbime teknike - Projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH, sh.a., dhe Bechtel Limited. “, si dhe Statuti i KESH sh.a.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1. Vështrim i Përgjithshëm mbi Klientin

KESH-i është subjekti publik i prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ai operon në kaskadën e lumit Drin, i strukturuar me tre hidrocentrale sipas modelit “basen” (“HEC”): sipas rrjedhës së Drinit, HEC Fierzë (500 MW), HEC Koman (600 MW) dhe HEC i Vaut të Dejës (250 MW). Duke përfshirë termocentralin FV të Qyrsaqit (5.14 MW), kapaciteti total i instaluar aktiv i gjenerimit të KESH arrin në 1,355.14 MW, duke përfaqësuar 52% të totalit të kapaciteteve të instaluar të prodhimit elektrik kombëtar. KESH mbulon më shumë se 60% të kërkesës totale të brendshme, duke e bërë atë prodhuesin më të madh kombëtar të energjisë elektrike. Për më tepër, KESH është një lojtar kyç në tregun balancues dhe ofruesi kryesor i shërbimeve ndihmëse.

Gjithashtu, KESH mban titullin e lojtarit më të madh të tregut me kapacitetin për të ofruar energji elektrike emergjente dhe në kohën e pikut. Lidhja e tregut me Kosovën e ka rritur më tej rëndësinë e KESH-it, pasi ofron në mënyrë efektive shërbime balancuese dhe ndihmëse për tregun e Kosovës, duke forcuar pozicionin e tij si forcë rajonale.

KESH, së bashku me Qeverinë Shqiptare, beson se Korporata mund të luajë një rol rajonal me rritjen e integritetit të tregut në Ballkanin Perëndimor. Kjo është kryesisht për shkak të potencialit të konsiderueshëm që KESH ka në ofrimin e energjisë në pikun dhe balancimin në tregun rajonal, veçanërisht duke pasur parasysh format mikse aktuale të gjenerimit rajonal dhe tranzicionin e vazhdueshëm nga qymyri në burimet e rinovueshme. Natyra e gjenerimit të luhatsëm e burimeve të rinovueshme pritet të kërkojë kapacitet të konsiderueshëm balancues në rajon për të ruajtur stabilitetin e sistemit elektroenergjitik.

2.2.Përshkrimi i Projektit Skavica

Për sa i përket kësaj strategjie, HEC-i i Skavicës është një nga projektet infrastrukturore me prioritet më të lartë në Shqipëri, që synon kompletimin dhe maksimizimin e elektro-gjenerimit të Kaskadës së Drinit. Aktualisht, Shqipëria prodhon mbi 95% të energjisë elektrike nga burimet hidrike nëpërmjet Hidrocentraleve ("HEC").

Projekti ndodhet në verilindje të Shqipërisë, afër kufirit me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. HEC-i i Skavicës do të shërbejë si diga e parë në rrjedhën e sipërme dhe rregullatori i tre hidrocentraleve kryesore ekzistuese në "Kaskadën e Drinit", në pronësi dhe operim të KESH-it. Duke qenë se qëllimi kryesor i projektit është rregullimi i prurjeve të ujit në rrjedhën e sipërme të HEC-eve ekzistues, ai nuk është i fokusuar në maksimizimin e prodhimit të energjisë dhe prandaj konsiderohet i papërshtatshëm për zhvillim privat.

Vendndodhja e projektit është në rajonin e Kukësit dhe Dibrës, i vendosur në një luginë të pjerrët menjëherë në rrjedhën e sipërme të rezervuarit ekzistues të Fierzës. Ndodhet 21 km në jug të qytetit të Kukësit (në vijë të drejtë) dhe 26 km në veri të Peshkopisë.

Sistemi i kaskadës për lumin Drin u studiua fillimisht mbi 50 vjet më parë kur u ndërtuan HEC-et në rrjedhën e poshtme. Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore në atë kohë, projekti nuk u arrit të realizohej. HEC-i i Skavicës është parashikuar gjithmonë si HEC-i rregullues në kaskadë, me një rezervuar që kontrollon prurjet në rrjedhën e poshtme dhe lehtëson përmytjet vjetore si në Fierzë ashtu edhe në Komani.

Projekti do të zotërohet dhe operohet nga KESH, si kompani publike, përgjegjëse për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike në Shqipëri.

2.3.Palët kryesore të lidhura

Palët kryesore të lidhura për këtë projekt janë:

Klienti: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.)

Pronësia: Qeveria Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zbatuesi i parashikuar: Bechtel International INC.

3. OBJEKTIVAT E SHËRBIMIT

Objektivat kryesor të kërkimit të shërbimeve këshillimore financiare janë:


- Diligenca e duhur financiare

- Rishikon të dhënat financiare, studion dhe vlerëson bankabilitetin financiar të Klientit në funksion të financimit të projektit.
- Kryerja e diligencës së duhur dhe rishikimi i modelit aktual financiar për HEC-in e Skavicës.
- **Financimi i Projektit/Korporatës**
 - Rishikon, këshillon dhe mbështet Klientin mbi financimin e projektit dhe kontrollon/rishikon çdo dokument që lidhet me projektin Skavica, duke gjetur pozicionin e kënaqshëm të klientit;
 - Kryen mbështetje për Klientin në vlerësimin e skenarëve të financimit, vlerësimin e opsioneve të financimit dhe termave të financimit.
- **Analiza dhe Zbutja e Riskut**
 - Identifikimi dhe zbutja e rreziqeve financiare që lidhen me projektin e HEC-it të Skavicës.
 - Kryen vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut, duke përfshirë rreziqet e tregut, ligjore/rregullatore, financiare dhe operacionale, dhe zhvillon skenare për të minimizuar/zbutur këto rreziqe.
- **Modelimi Financiar dhe Pasqyrave**
 - Zhvillimi i modeleve solide financiare për analizën e fizibilitetit të HEC-it të Skavicës.
 - Krijon modele/skenarë të detajuar financiarë për të vlerësuar fizibilitetin e projektit, parashikimet e fluksit të parasë dhe kthimin nga investimi dhe pasqyrat financiare që ndihmojnë në vendimmarrjen për financimin e projektit.
- **Analiza e Ekonomike e Kaskadës**
 - Për sa i përket vlerësimit të përfitueshmërisë së përgjithshme, analizon ndikimin e përgjithshëm të kaskadës së Drinit dhe konkretisht ndikimin operativ-ekonomik të projektit Skavica në kaskadën e Drinit.
 - Sigurimi i një vlerësimi/modeli ekonomik të HEC-it të Skavicës duke përfshirë përfitimet direkte dhe indirekte, dhe kryerja e analizës së përgjithshme kosto-përfitim për variante të ndryshme të projektit (lartësia e digës).
- **Optimizimi i Strukturës së Kapitalit**
 - Optimizimi i strukturës së financimit të kapitalit të Projektit të HEC-it të Skavicës.
 - Të këshillojë për financimin optimal të borxhit, duke marrë parasysh koston e kapitalit dhe tolerancën ndaj riskut.
- **Komunikimi me palët e lidhura**
 - Komunikimi efektiv i informacionit financiar tek palët e interesuara.
 - Zhvillon raporte të qarta dhe konçize financiare, prezantime dhe komunikimi transparent ekskluzivisht për Klientin ose Qeverinë/MIE.

4. FUSHA E VEPRIMTARISË

4.1. Informacion i Përgjithshëm

Klienti kërkon një kompani me përvojë të Këshillimit Financiar për të ofruar fushën e nevojshme të shërbimeve në lidhje me qëllimin e financimit të Projektit të HEC-it të Skavicës. Fushëveprimi i Marrëveshjes mandaton që Kompania e Këshillimit Financiar të ofrojë gamën e plotë të shërbimeve, duke vepruar në emër dhe në interesin më të mirë të KESH-it për këtë projekt, sipas fushës së veprimtarisë, si më poshtë:



4.2.Përshkrimi dhe Fazat e Fushës së Veprimtarisë/Shërbimeve

4.2.1 Detyra 1 – Bankabiliteti i KESH

- Mundësitë financiare gjithëpërfshirëse dhe aftësia e bankabilitetit të KESH për të mbështetur qëndrueshmërinë e Projektit të Skavicës.
- Përdorimi i informacionit të dhënë nga KESH për të kryer një vlerësim të plotë të aftësive financiare dhe aftësisë bankare/kredimarrëse të Klientit.
- Siguron këshilla për klientin mbi aftësitë e tij financiare në lidhje me projektin e Hidrocentralit të Skavicës. Kjo përfshin vlerësimin e strukturave financiare, rekomandimin e llojeve të garancive, për të shmangur potencialisht nevojën për garanci sovraane, vlerësimin e instrumenteve financiar (letrat me vlerë) dhe kryerjen e një vlerësimi të riskut.

4.2.2 Detyra 2 - Fizibiliteti Financiar i HEC-it të Skavicës

- Kryerja e një rishikimi të modelit aktual financiar për HEC-in e Skavicës;
- Ekipi teknik ka ofruar të dhëna CAPEX për tre lartësitë e digave. Këshilltari financiar do të vlerësojë kostot për njësi dhe CAPEX-in e përgjithshëm. Kontraktori, përgjegjës për përgatitjen e zgjidhjeve teknike, studimeve të fizibilitetit dhe vlerësimeve të ndikimit në mjedis (por jo të kufizuar) për projektin e HEC-it të Skavicës, ka përgatitur

projektin paraprak dhe do të sigurojë CAPEX-in për të paktën tre alternativa. KESH do ti sigurojë Këshilltarit Financiar të dhënat CAPEX dhe modelin financiar të hartuar nga kontraktori. Këshilltari Financiar i emëruar për këtë fushë veprimtarie ka për detyrë të rishikojë, vlerësojë dhe ndryshojë modelin financiar. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë ofrimin e rekomandimeve dhe ofrimin e një modeli financiar të përmirësuar që vlerëson tërësisht fizibilitetin financiar të projektit.

- Rivlerësimi dhe vlerësimi i Shpenzimeve Operative (OPEX) dhe të ardhurave të krijuara nga Hidrocentrali i Skavicës (HEC), duke marrë parasysh rritjen e kapaciteteve gjeneruese dhe përmirësimin/ndikimin i përgjithshëm i menaxhimit të prurjeve në HEC-et ekzistuese brenda Kaskadës së Drinit.

Këshilltari Financiar (FA) është i ngarkuar me rishikimin, vlerësimin dhe ndryshimin e OPEX-it dhe të ardhurave të parashikuara për HEC-in e Skavicës. Kjo përfshin llogaritjen e rritjes së kapaciteteve gjeneruese në HEC-et ekzistuese brenda Kaskadës së Drinit.

Duke përdorur të dhëna nga KESH ose konsulentët që përfaqësojnë KESH-in, Këshilltari Financiar duhet të zhvillojë një model financiar që vlerëson tarifën e energjisë elektrike për ndërtimin dhe funksionimin e HEC-it të Skavicës në skenarë të ndryshëm.

Duke përdorur modelin financiar të detajuar dhe supozimet e mbledhura nga analiza e tregut, inkorporojnë funksionimin e Kaskadës së Drinit në vlerësim. Kjo synon të vlerësojë tarifën kombëtare të energjisë elektrike të lidhur me funksionimin e kombinuar të HEC-it të Skavicës dhe Kaskadës së Drinit sipas skenarëve të ndryshëm;

- Të integrojnë në modelin financiar strukturën e financimit dhe kostot e mundshme që lidhen me financimin e Hidrocentralit të Skavicës.

Vlerëson strukturën e mundshme financiare të Hidrocentralit të Skavicës (HEC) të përshtatur për këtë projekt specifik, duke marrë parasysh skemat e financimit që mund të eliminojnë nevojën për një garanci sovraane. Për më tepër, vlerëson garancitë alternative dhe instrumentat financiar (letrat me vlerë) që mund të ofrohen, duke analizuar rreziqet, kostot dhe ndikimin e tyre në fizibilitetin e projektit.

Modeli financiar gjithëpërfshirës, i zhvilluar si pjesë e detyrave të sipërpërmendura, duhet të jetë mjaft i gjithanshëm për të përfshirë skenarë të ndryshëm financimi dhe operimi. Ai duhet të përfshijë një bilanc financiar, pasqyrë fitimi dhe humbje dhe pasqyrë të rrjedhës së parasë.

- Modeli financiar gjithëpërfshirës duhet t'i nënshtrohet analizave të ndjeshmërisë dhe të paraqitet në një format që i mundëson KESH-it të simulojë dhe vlerësojë skenarë të ndryshëm. Kjo përfshin ndryshime në inputet e ndjeshme si lartësia e digës/gjenerimi, strukturat e financimit dhe kostot përkatëse, kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC), kostoja e niveluar e energjisë elektrike (LCOE), ndryshimet në çmimet e energjisë, efektet e inflacionit, dhe të tjera.

Ndërtimi i një modeli financiar të detajuar duhet të mundësojë analiza financiare të Projektit sipas skenarëve të ndryshëm, duke përfshirë, por jo kufizuar në:

- Konfigurime të ndryshme teknike të Projektit (p.sh., lartësia e digës, prodhimi elektrik, kostot e zhvendosjes).
- Struktura të ndryshme financimi (p.sh. maturiteti, norma e interesit, periudha e pauzës, profili i ripagimit, kërkesat për rezervë financiare, etj.).
- Parashikime për ndryshime të çmimeve të energjisë elektrike, regjime operimi dhe

supozime në lidhje me të ardhurat nga shërbimet ndihmëse.

- Kërkesa të ndryshme mbi kthimin, duke përfshirë normën e brendshme të kthimit (IRR), vlerën aktuale neto (NPV), periudhën e kthimit, kthimin nga investimi (ROI), kthimin nga kapitali (ROE), etj.
- Paraqet treguesit kryesorë financiarë në mënyrë dinamike, duke përfshirë fluksin e parasë së lirë operativ (FCF), Normën e Brendshme të Kthimit (IRR), Raportin e Mbulimit të Shërbimit të Borxhit (DSCR), Vlerën aktuale neto (NPV), Të ardhurat para interesit, taksave, amortizimit dhe zhvlerësimit (EBITDA), Të ardhurat para interesit dhe taksave (EBIT) dhe tregues të tjerë përkatës.
- Vlerëson fizibilitetin financiar dhe ekonomik të Projektit, duke përfshirë një vlerësim të aftësisë së tij, ndaj çdo shërbimi të lidhur borxhi, sipas një sërë skenarësh të pafavorshëm;
- Identifikon strukturat e mundshme të financimit të borxhit, burimet dhe strategjitë e nevojshme ose të dëshirueshme për të maksimizuar financimin për Projektin, me synimin për të minimizuar ose eliminuar çdo kërkesë paraprake për financimin e kapitalit;
- Angazhohet me Agjencitë e Kredisë së Eksportit (ECA), Institucionet Financiare të Zhvillimit (DFI), bankat ndërkombëtare dhe rajonale, kompanitë private të sigurimit dhe burime të tjera financimi për të vlerësuar gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në financimin e borxhit të Projektit;
- Marrin Letrat e Interesit (LoI) ose dokumente të ngjashme nga Agjencitë e Kredisë së Eksportit (ECA), Institucionet Financiare të Zhvillimit (DFI), bankat ndërkombëtare dhe rajonale, siguresit privatë ose burime të tjera financimi.

Këto letra duhet të konfirmojnë prej tyre:

- gatishmërinë për të mbështetur financimin me borxh të Projektit,
- shumën maksimale të borxhit ose mbulimit që mund të jetë në dispozicion,
- termat kyçe të lidhura me çdo mbështetje financiare (përfshirë primet e riskut/tarifat paraprake), duke përfshirë supozime mbi maturitetin dhe interesit dhe,
- detajet e nivelit të miratimit të marrë nga brenda për termat e tillë të LoI (së bashku me një shpjegim të procesit të kërkuar/të nevojshëm për të marrë miratimin përfundimtar);
- Përgatitja e një plani paraprak financimi që përfshin një program kohor të detajuar që çon në përmbylljen e marrëveshjes financiare, duke theksuar momentet kyçe që duhen arritur brenda këtij afati kohor;
- Përzgjedh dhe kontrollon konsulentin(ët) e palëve të treta për të prodhuar çdo raport të kërkuar, duke përfshirë ato që lidhen me tregun e energjisë elektrike ose fusha të tjera, në rastet kur Këshilltarit Financiar i mungojnë kapacitetet/aftësitë e brendshme për të gjeneruar në mënyrë të pavarur raporte të tilla;
- Kryen një analizë të ndikimeve të zinxhirit të furnizimit në zbatueshmërinë e projektit, duke marrë parasysh aspektet e lidhura me koston, si parashikimet mbi inflacionin dhe rrezikun e rritjes së koston, dhe nga një perspektivë e disponueshmërisë së financimit të ECA;
- Përgatit dhe dorëzon një raport gjithëpërfshirës mbi zbatueshmërinë/qëndrueshmërinë e përgjithshme ekonomike të Projektit. Ky raport, duhet të përfshijë një vlerësim të

strukturave të ndryshme financuese, duke përshkruar përfitimet dhe sfidat që lidhen me secilën. Gjithashtu, jep rekomandim për strukturën më të përshtatshme të financimit për Projektin.

4.2.3 Detyra 3 - Fizibiliteti Ekonomik i HEC-it të Skavicës

Duke pasur parasysh se, disa kosto do të mbulohen nga Qeveria e Shqipërisë dhe duke njohur përfitimet indirekte të projektit, të tilla si:

- Kostot e restaurimit dhe rialokimit të kushteve/mënyrës të jetesës sipas standardeve të IFC;
- Rivendosja e Trashëgimisë Kulturore (TK) dhe Mjedisit;
- Kuantifikimi dhe vlerësimi i çdo kostoje dhe përfitimi indirekt që lidhet me ndërtimin dhe funksionimin e Projektit (p.sh. zbutja e riskut ndaj përmbytjeve, impakti në zhvillim, krijimi i vendeve të punës, kostot e zhvendosjes, etj).

Siguron Modelin Ekonomik të Hydrocentralit të Skavicës (HEC) duke përfshirë përfitimet direkte dhe indirekte dhe duke kryer analiza kosto-përfitim për lartësi të ndryshme digash. Zhvillimi i modelit të fizibilitetit ekonomik duhet të përputhet me modelin financiar të përshkruar në Detyrën 2.

4.2.4 Detyra 4 – Rishikon dhe Ndryshon SoW të Organizuesit Financiar Potencial

- Rishikon dhe ndryshon Fushën e Veprimtarisë (SoW) për Organizuesin Financiar, duke përgatitur KESH-in për të përshtatur kërkesat për thirrjen për një Organizues Financiar për Hydrocentralin e Skavicës. KESH do të sigurojë një draft të Fushës së veprimtarisë (SoW) dhe dokumentet përkatëse për Organizuesin Financiar. Këshilltari Financiar do të ngarkohet me rishikimin, vlerësimin dhe ndryshimin e dokumenteve, duke ofruar një SoW të përmirësuar dhe dokumente përkatëse për një thirrje për një Organizues Financiar potencial, duke mbështetur Klientin në këtë proces.

4.3. Takimet dhe Marrëdhëniet

- Të ofrojë mbështetje për KESH-in në lidhje me përgatitjen për çdo takim me Qeverinë e Shqipërisë (GoA) ose autoritete/grupe të lidhura, në lidhje me financimin e projektit, fizibilitetin ekonomik dhe financiar dhe vendimin përfundimtar mbi investimin për Projektin;
- Nëse kërkohet nga KESH, merr pjesë personalisht në çdo takim me Qeverinë e Shqipërisë ose autoritete/grupe të lidhura;
- KESH do të caktojë një grup përfaqësues, i cili do të mbajë marrëdhëniet, takimet dhe kontaktet me Këshilltarin Financiar.

4.4. Support

- Të ofrojë çdo mbështetje shtesë ad-hoc, sipas kërkesës nga KESH sh.a.

4.5. Raporte dhe Dorëzime

Ndarja e elementeve kryesore në listën e dhënë:

- Bankabiliteti dhe struktura financiare e KESH-it.

- Vlerësimi i aftësisë së bankabilitetit të KESH-it dhe zhvillimi i një strukture financiare potenciale për Hidrocentralin e Skavicës;
- Kryen një analizë të detajuar të kostos së Shpenzimeve Kapitale (CAPEX) të lidhura me projektin;
- Modeli financiar me skenarë të ndryshëm me rastet e ndjeshmërisë i cili do të përfshijë, por pa u kufizuar në, një raport të detajuar mbi fizibilitetin e secilit skenar, risqet, garancitë, kostot financiare, OPEX, të ardhurat e krijuara, analizat e tregut të tarifave, të ardhurat e pritshme të gjeneruara, treguesit e kthimit etj.;
- Modeli ekonomik me skenarë të ndryshëm me rastet e ndjeshmërisë i cili do të përfshijë, por pa u kufizuar në, një raport të detajuar mbi fizibilitetin e secilit skenar, rreziqet, garancitë, kostot financiare, OPEX, të ardhurat e krijuara, analizat e tregut të tarifave, të ardhurat e pritshme të gjeneruara, treguesit e kthimit, analizat e kosto-perfitimit direkte dhe indirekte etj.;
- Letra interesi nga Agjencitë e Kredisë së Eksportit (ECA), Institucionet Financiare të Zhvillimit (DFI) dhe institucione të tjera financuese.
- Kërkesë për Propozim (RfP) për Organizuesin Financiar;
- Raportet e progresit (komentet e KESH-it). Siguron raporte progresi bazuar në komentet dhe reagimet e marra nga KESH;
- Raportet e progresit mbi takimet e ndjekura dhe mbështetjen e dhënë për KESH, bazuar në ndërveprimet me Qeverinë e Shqipërisë;
- Raportet (nëse ka) në lidhje me mbështetjen ad-hoc sipas nevojës.

5. KRITERET E PRANUESHMËRISË

Kriteret e pranueshmërisë për shërbimet e këshillimit financiar duhet të sigurojnë që Kompanitë e mundshme të shërbimit të kenë kualifikimet, përvojën dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur nevojat specifike të Klientit. Më poshtë janë kriteret kryesore të pranueshmërisë për shërbimet e këshillimit financiar:

- **Fusha e përgjithshme e ekspertizës/shërbimeve**

Ekspertizë shumë profesionale në fushën e shërbimeve të fokusuar në:

- Auditimi dhe Sigurimet;
- Këshillim ligjor dhe Diligenca financiare;
- Shërbimet e Këshillimit për Biznes/Korporatë;
- Këshillim financiar, duke përfshirë menaxhimin e pasurisë dhe menaxhimin e investimeve;
- Këshillim për risqet;
- Shërbimet e menaxhuara dhe tatimore.

- **Fusha Specifike e Ekspertizës**

Brenda fushës së përgjithshme të ekspertizës/shërbimeve, kompania duhet të ketë eksperiencat e mëparshme të vërtetuara specifike me Agjenci të Kredisë së Eksportit (ECA)/Institucione Financiare të Zhvillimit.

- **Pajtueshmëria Ligjore dhe Rregullatore**

Ofruesi i shërbimit duhet të ofroj shërbimin e tij, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

- **Kualifikimet dhe Çertifikimet Profesionale**

Ekipi këshillues financiar duhet të ketë kualifikime dhe certifikime profesionale përkatëse, referuar ofrimit të shërbimeve të kërkuara në këtë ToR.

- **Stabiliteti Financiar**

Stabiliteti financiar i shoqërive këshillimore financiare, duke siguruar që ato të kenë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe për të mbështetur shërbimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij. Referuar pasqyrave financiare të audituara të 2 (dy) viteve radhazi më të fundit, të paktën në njërin prej tyre, shoqëria duhet të ketë të ardhura (xhiro) të çertifikuara të barabartë ose mbi 1.5 (një pikë pesë) Milion Euro ose ekuivalent. (*kopje e Pasqyrave Financiare të audituara dhe të çertifikuara të 2 viteve më të fundit*).

- **Sigurimi dhe Përgjegjësia**

Shoqëria këshilluese financiare duhet të pajiset me një mbulim sigurimi të përgjegjësive profesionale siç kërkohet në industri për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në ToR. (*kopje e policës së sigurimit në fuqi*).

- **Deklarimi i Konfliktit të Interesit**

Çdo konflikt i mundshëm interesi që mund të lindë gjatë angazhimit, duke siguruar transparencë dhe sjellje etike duhet të deklarohet.

- **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**

Pajtueshmëria me sistemet e menaxhimit të cilësisë ose standardet e industrisë që lidhen me shërbimet e këshillimit financiar duhet të sigurohet, për të ofruar shërbime me cilësi të lartë nga kompania e këshillimit financiar.

- **Siguria dhe Konfidencialiteti i të Dhënave**

Masat e sigurisë së të dhënave dhe një angazhim për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjithë informacionit duhet të vendosen nga Kompania e Këshillimit Financiar.

- **Standardet Etike**

Respektimi i standardeve të larta etike në kryerjen e shërbimeve këshillimore financiare, duke përfshirë ndershmërinë, integritetin dhe pajtueshmërinë me udhëzimet etike ose kodet e sjelljes duhet të vendosen si procedura në FAC.

6. KUALIFIKIMET DHE KËRKESAT

Ofruesit e mundshëm të Shërbimeve Këshillimore Financiare duhet të posedojnë:

- **Kualifikimet dhe Përvoja e Ekipit të Këshilluesit Financiar**

- Minimumi 12 vjet përvojë relevante të drejtuesit të ekipit të FA;
- Përvojë relevante për anëtarët e tjerë të ekipit që ofrojnë sipas fushës së përgjithshme të ekspertizës;
- Përsa i përket ekspertizës, përvojë specifike me ECA/DFI;
- Lidhur me përfundimin e Detyrës 3, Këshilltari Financiar mund të angazhojë ekspertë të tjerë në fusha të tilla si trashëgimia kulturore, rivendosja e mjedisit

etj., të cilët duhet të plotësojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse referuar anëtarëve të tjerë kryesor të ekipit të Këshilltarit.

- **Experiencë dhe Shërbime në Sektorin e Energjisë**
 - Në kuadër të fushës së përgjithshme të ekspertizës/shërbimeve, subjekti duhet të ofrojë dokumenta/referenca për shërbimet e ofruara ndaj klientët e mëparshëm në sektorin e energjisë.
- **Aftësi Analize Financiare dhe Modelim**
 - Aftësi në analizën financiare, duke përfshirë aftësinë për të kryer vlerësime të thelluara financiare dhe për të krijuar modele të konsoliduara financiare.
 - Përvojë në parashikime dhe analiza të skenarëve.
- **Mendimi dhe Planifikimi Strategjik**
 - Aftësia për të zhvilluar një plan financiar gjithëpërfshirës dhe strategjik në përputhje me objektivat e Klientit.
 - Aftësi për të dhënë rekomandime të detajuara për përmirësime financiare mbi zhvillimin e projekteve.
- **Strategjia e Financimit dhe Struktura e Kapitalit**
 - Ekspertizë në zhvillimin e strategjive të financimit dhe optimizimin e strukturave të kapitalit.
 - Njohuri të opsioneve të ndryshme të financimit, përfshirë borxhin, kapitalin etj.
- **Menaxhimi i Rrezikut dhe Pajtueshmëria**
 - Metodologji e lartë profesionale e parimeve të menaxhimit të riskut dhe aftësi për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet financiare.
 - Njohuri të larta profesionale të rregulloreve përkatëse financiare dhe përkushtim për të siguruar pajtueshmërinë.
- **Komunikimi**
 - Qartësia dhe efektiviteti në komunikim, duke përfshirë aftësinë për të përcjellë informacion kompleks financiar në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshëm.
 - Përgjegjshmëri dhe transparencë në komunikim.
- **Kosto-Efektiviteti**
 - Struktura e kostos dhe transparenca në çmim.
 - Vlera në para në lidhje me shërbimet e ofruara.
- **Menaxhimi i projektit**
 - Aftësi të demonstruara për menaxhimin e projektit.

Aplikanti i Këshillimit Financiar duhet të përfshijë dokumentet përkatëse për të demonstruar dhe garantuar përputhshmërinë me kualifikimin dhe kërkesat, si dhe duhet të paraqesë dokumentin "Përfaqja dhe Metodologjia e Propozuar" sipas këtij ToR.

7. KOHËZGJATJA DHE PESHA FINANCIARE SIPAS DETYRAVE

Bazuar në Fushën e veprimtarisë (SoW), shërbimi është planifikuar të kryhet një nga një, sipas renditjes së detyrave. Referuar këtij segmentimi, kohëzgjatja e shërbimit, pesha (%) në ofertën ekonomike dhe pagesa përkatëse për shërbimin e ofruar, është planifikuar në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi i Fazave	Kohëzgjatja Aktive	Periudha e Konsolidimit	Pesha në Ofertën Ekonomike (%)	Pesha në Pagesën e Shërbimit (%)
Task 1 – Bankabiliteti i KESH	2 muaj	2 javë	40%	40%
Task 2 – Fizibiliteti Financiar HEC Skavica	2 muaj	2 javë	30%	30%
Task 3 - Fizibiliteti Ekonomik HEC Skavica	1.5 muaj	2 javë	20%	20%
Task 4 - SoW dhe dokumentet përkatëse për thirrje për një Organizues Financiar Potencial	0.5 muaj	1 javë	10%	10%
TOTAL	6 Muaj	7 Javë	100%	100%

- Çdo detyrë ka një kohëzgjatje aktive. Gjatë kësaj periudhe, Këshilltari Financiar duhet të përgatisë dhe të sigurojë draft raportet/dokumentet për Klientin, për detyrën përkatëse;
- Periudha e Konsolidimit, është një kohë e ndërmjetme (pas kohëzgjatjes aktive), kur Klienti dhe Këshilltari Financiar shkëmbejnë komente, shpjegime, informacione shtesë, rishikime etj., mbi draft raportet/dokumentet e detyrës përkatëse. Në fund të kësaj periudhe rakordimi, Këshilltari Financiar i dorëzon Klientit, raportet/dokumentet përfundimtare të konsoliduara (sipas formatit origjinal dhe të printuar) për detyrën përkatëse (fondi i detyrës);
- Periudha e konsolidimit nuk duhet të përfshihet/llogaritet në kohëzgjatjen e kontratës. Pra, kohëzgjatja kontraktuale është e barabartë me kohëzgjatjen aktive (6 muaj);
- Pesha në ofertën ekonomike përfaqëson nivelin e rëndësisë së çdo detyrë. Oferta ekonomike nga kandidati duhet të paraqitet veçmas për secilën detyrë. Ky segmentim zbatohet sepse, pas përfundimit të çdo detyrë, Klienti ka të drejtë të ndërpresë shërbimin/kontratën me FA (jo për arsye që lidhen me performancën kontraktuale dhe cilësinë e shërbimit të FA), por për arsye që lidhen me Projektin. Kjo është arsyeja e segmentimit të detyrës sipas renditjes, peshës në ofertën ekonomike për aplikantin dhe peshës përkatëse në shërbimin e pagesave për Këshilltarin Financiar;
- Kontrata bëhet e vlefshme dhe do të fillojë menjëherë pasi Klienti t'i dorëzojë Këshilltarit Financiar dokumentacionin/informacionin e nevojshëm paraprak në lidhje me Projektin.